



HEC LANABREGAS SH.A.



Nr. _____ Prot

Tiranë, më ____ . ____ . 2024

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT (PARAPRAK)

03.04.2024

Drejtuar: BOE "Ligus" shpk & "AZ Trading" shpk

Nipt L51523001S & NIPT L81515016F

Adresa: "Kashar, Rruga Teodor Keko, Pallati 2 Art Kontruksion, Ap. 13" & "Nj. Adm Nr.7, Blv. Gjergj Fishta, Kulla G&P, Kati 1"

Procedura e prokurimit/lotit: Procedure e hapur, prokurim publik me mjete elektronike

Numri i procedurës / referenca e Lotit: **REF – 97575-03-06-2024**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: "Zëvendësimi i paneleve të kontrollit, sinkronizimit, mbrojtjeve dhe pajisjeve matëse të agregatëve AG.1, AG.2 me sistemin digjital SCADA".

Fondi limit: 36,745,000 (tridhjetë e gjashtë milionë e shtatëqind e dyzetë e pesë mijë) lekë pa TVSH.

Kohëzgjatja e kontratës: Duke filluar nga data e fillimit të punimeve me përfundim brenda 5 (pese) muajve.

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Nuk ka

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori Ekonomik "NOVAMAT" shpk

NUIS K81615002O

Vlera e ofertës = 34,838,496 (tridhjetë e katërmilionë e tetëqind e tridhjetë e tetë mijë e katërqind e nëntëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH.

2. BOE "LIGUS" shpk & "AZ TRADING" SHPK"

NUIS L51523001S & L81515016F

Vlera e ofertës = 35,616,225 (tridhjetë e pesë milionë e gjashtëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e dyqind e njëzetë e pesë) lekë pa TVSH.

3. Operatori Ekonomik “MUHOPLUS LTD” shpk NUIS L52317046G

Vlera e ofertës = 36,263,375 (tridhjetë e gjashtë milionë e dyqind e gjashtëdhjetë e tremijë e treqind e shtatëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

1. Operatori Ekonomik “NOVAMAT” shpk NUIS K81615002O

Operatori ekonomik “NOVAMAT” shpk (ne vijim OE) me NIPT K81615002O skualifikohet për arsyet e mëposhtme:

Referuar Kriteve të Vecanta të Kualifikimit, të pasqyruara në Dokumentat Standarte të Tenderit, sqarojme se:

a) Oferta ekonomike e paraqitur nga OE ofertues NOVAMAT shpk konsiderohet e pasaktë pasi në Shtojcën 1- **Formularin e Ofertës** dhe Shtojcën 2 – **Lista e çmimeve të artikujve** nuk i ka paraqitur sipas formateve të përcaktuara në shtojcat përkatëse të llojit të procedurës “E hapur – Pune”, sipas të cilave janë hartuar dokumentat e tenderit të publikuar në APP. Specifikisht në Shtojcën 1, pika c) ka cituar: “*Ne ofrojmë ti furnizojmë Autoritetit Kontraktor HEC Lanabregas sh.a ne përputhje me Dokumentat e Tenderit, mallrat për 45232200-4- Punime ndihmese për linja të energjise elektrike ne përputhje me Oferten Teknike, me çmimet e renditura në Listen e Artikujve dhe ne përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontrates, të cilat reflektohen në Dokumentat e Tenderit”, nderkohe në DST citohet “Ne ofrojmë të realizojmë për Autoritetit/Entit Kontraktor [**vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor**], në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), punimet për [vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE] në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në preventiv, me të gjitha projektet teknike, e me kërkesat në detyrën e projektimit apo termat e referencës, nëse është rasti, dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit”. Përsa i përket pikës d) ka pasqyruar, pasi në Shtojcën e plotësuar nga OE nuk janë pasqyruar të 10 pikat të renditura sipas DST por vetëm 7 prej tyre. KVO gjykon se në rastin konkret jemi në kushtet e mosplotësimit në formën e duhur të një shtojce e cila është pjesë përbërëse e dokumentave të procedurës objekt prokurimi dhe është e detyrueshme që të plotësohet sipas formatit të miratuar nga organet ligjzbatuese. Për këtë shkak shtojca 1 e dorëzuar nga operatori ekonomik nuk konsiderohet e rregullt pasi nuk përmban të gjithë elementët e nevojshëm dhe të detyrueshëm për t’u plotësuar. Në rast se, operatori ekonomik do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesës së mësipërme, ka patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor të parashikuar nga neni 75 i LPP-së.*

Gjithashtu OE nuk ka plotësuar Shtojcën 2 sipas preventivit të dhënë nga Autoriteti Kontraktor. Konkretisht OE ka perlllogaritur fond rezerve mbi të gjithë artikujt e preventivit dhe jo vetëm për “Kabllot e Kontrollit/komandimit/ushqimit” sic përcaktohet në preventivin e publikuar në APP, rrjedhimisht kjo përlllogaritje sjell një gabim ekonomik në ofertë dhe e bën ofertën të pavlefshme. Në LPP Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", neni 92, pika 3, parashikohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me

të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”. Në VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 82 parashikohet se: “Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme”.

b) Formulari Permbledhes i Vetëdeklarimit (Shtojca 8) i paraqitur nga NOVAMAT shpk nuk është plotësuar sipas formatit të kërkuar në DST e procedurës.

Ne pjesën II – Shkaqet e Perjashtimit pika A: DEKLARATA PER PERMBUSHJEN E KRITEREVE TE PERGJITHSHME TE KUALIFIKIMIT, OE citon “Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë: etj. nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj”, ku ka deklaruar vetëm administratorin e kompanisë, nderkohe sipas Shenimit të vendosur në DST e procedurës dhe të publikuara duhet të deklaronte të gjithë personat që kanë vendimmarrje qofte edhe teknike, si Drejtuesi Teknik.

Ne Pjesën III - Kriteret e përzgjedhjes/kualifikimit, pika A “Për përmbushjen e specifikimeve teknike dhe grafikut të realizimit të objektit të kontratës” teksti i deklaruar nuk është sipas formatit në DST specifikisht nder të tjera thuhet: “... dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me Listen e Mallrave dhe grafikun e Levrimit të përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor” nderkohe që sipas dokumentave të tenderit do të ishte “... dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me preventivin e punimeve dhe grafikun e zbatimit të punimeve të përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor”.

Ne pjesën III Pika B: DEKLARATË “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate” nuk është deklaruar numrin i punonjësve sipas Kriterit 2.3.3 si dhe teksti i deklaruar nuk është sipas formatit në DST.

Gjithashtu për pikën C në lidhje me deklarimin e makinerive dhe mjeteve të nevojshme për realizimin e punimeve, OE ka pranuar vetëm disponimin e tyre (përveç deklarimit të informacionit të plote për mjetin Daimler Chrysler dhe të dhenat e tij) por pa specifikuar me të dhëna konkrete për pjesën tjetër të mjeteve si më poshtë sipas Kriterit 2.3.8, siç kërkohen në Formularin e Vetëdeklarimit:

- Megaohmeter 1000 volt,
- Multimeter dixhital 1000VDC 750VAC CAT IV,
- Aparat testimi për relete e mbrojtjes dhe kontrollit me rryme maksimale në dalje 3x75A,
- Dare ampermetrike 1500A,
- Indikator i sensit të fazave

Për plotësimin e kësaj pike, OE ka paraqitur një deklaratë për disponueshmërinë e mjeteve por në këtë deklaratë nuk vërteton pronësinë e tyre me anë të dokumentave të njohura ligjërisht (fatura blerje, kontrate qiraje, deklarate doganore-import, akt dhurimi etj).

c) OE nuk vërteton se plotëson pikën 2.3.4: Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar 1 (një) inxhinier elektrik, të certifikuar nga prodhuesi i releve për instalimin dhe konfigurimin e tyre, si dhe 1 (një) inxhinier elektrik, të certifikuar nga prodhuesi i sistemit SCADA për instalimin dhe konfigurimin e SCADA-s, pasi për të dy inxhinierët elektrik të

paraqitur nuk ka deklaruar në formularin e përgjithshëm të deklarimit se janë të certifikuar nga prodhuesi ose certifikim ekuivalent dhe gjithashtu në dokumentat e paraqitura për këta inxhinierë nuk rezulton asnjë certifikim, i cili vërteton plotësimin e kësaj pike të kriterëve të vecanta për kualifikim.

- d) OE nuk plotëson piken 2.3.5. Për listën e mëposhtme të komponentëve përbërës të secilit panel, si dhe për kabllot e kontroll-komandimit: OE nuk ka paraqitur autorizim prodhuesi dhe as katalog për komponentët:
- Moduli i hyrjeve dixhitale,
 - Moduli i daljeve dixhitale,
 - Moduli i hyrje-daljeve analoge,
 - Moduli i procesimit të të dhënave,
 - Monitoruesi i rrjetit,
 - Ekran 15" HMI,
 - Lëshues manual i motorave,
 - Testblloqe,
 - Automatë katër polarë AC 380 V, 2A (Me kontakte ndihmëse),
 - Automatë dy polarë 220 V DC, 10/16/20/25/A (Me Kontakte ndihmëse).
- e) Nga kontrolli i dokumentacionit të hedhur në SPE, rezultoi se dokumentacioni i emertuar “Paneli AC.pdf” nuk hapet dhe në të pasyrohet shënimi: (Error) (Failed to load PDF document).

2. Operatori Ekonomik “MUHOPLUS LTD” shpk

NUIS L52317046G

Referuar Kriterëve të Vecanta të Kualifikimit, të pasqyruara në Dokumentat Standarte të Tenderit, sqarojme se:

- a) **Formulari Permbledhes i Vetëdeklarimit (Shtojca 8)** i paraqitur nga MUHOPLUS shpk nuk është plotësuar sipas formatit të kërkuar në DST e procedurës.
Ne pjesën III B: DEKLARATË “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate” është deklaruar vetëm një inxhinier elektrik, nderkohe që në kriterin 2.3.4 është specifikuar që nevojiten dy inxhinierë elektrikë të certifikuar sipas prodhuesit perkates.
Ne pjesën III pika C në lidhje me deklarimin e makinerive dhe mjeteve të nevojshme për realizimin e punimeve, OE ka pranuar vetëm disponimin e tyre por pa specifikuar me të dhëna konkrete secilin mjet që është kërkuar sipas kriterit 2.3.8.
Për plotësimin e kësaj pike, OE ka paraqitur një deklaratë për disponueshmërinë e mjeteve por në këtë deklaratë nuk vërteton pronësinë e tyre me anë të dokumentave të njohura ligjërisht (*facture blerje, kontrate qiraje, deklarate doganore-import, akt dhurimi etj*).
- b) OE nuk ka dorëzuar në Sistemin e Prokurimeve Publike asnjë dokument që vërteton Kriterin 2.2.1 mbi kopje të deklaratave të xhiros vjetore dhe bilanceve të kërkuar sipas viteve perkatese, si dhe Kriterin 2.2.2 mbi Vërtetimin për shlyerjen e tarifave dhe taksave nga Pushteti Vendor për Vitin 2023.
- c) OE nuk përmbush Kriterin 2.3.2, sipas se ciles duhet të percaktonte me anë të një Deklarate drejtuesin teknik të punimeve i cili do të ishte i panagazhuar në asnjë kontratë tjetër, gjatë kohezgjatjes së punimeve. Nuk rezultoi në dokumentat e dorëzuar asnjë deklaratë e tillë.
- d) OE nuk vërteton se plotëson piken 2.3.4: Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar 1 (një) inxhinier elektrik, të certifikuar nga prodhuesi i releve për instalimin dhe konfigurimin e tyre, si dhe 1 (një) inxhinier elektrik, të certifikuar nga prodhuesi i sistemit SCADA për instalimin dhe konfigurimin e SCADA-s, pasi për të dy inxhinierët elektrik të paraqitur nuk ka deklaruar në formularin e përgjithshëm të deklarimit se janë të certifikuar nga prodhuesi ose certifikim ekuivalent dhe gjithashtu në dokumentat e paraqitura për këta

inxhinierë nuk rezulton asnjë certifikim, i cili vërteton plotësimin e kësaj pike të kriterëve të vecanta për kualifikim.

- e) OE nuk ka permbushur Kriterin 2.3.5 pasi nuk ka dorezuar asnjë dokument të perkthyer dhe të noterizuar mbi pajisjet e kerkuara ne kete kriter.
- f) OE nuk ka permbushur Kriterin 2.3.8 pasi nuk ka dorezuar asnjë dokument qe vërteton pronësine e mjeteve dhe pajisjeve teknike te percaktuara per kryerjen e punimeve, me anë të dokumentave të njohura ligjërisht (*fature blerje, kontrate qiraje, deklarate doganore-import, akt dhurimi etj*).

Sa më sipër Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, bazuar në nenin 92, pika 3 të ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet: “*Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji*”, vendosi të refuzojë ofertat e Operatorëve Ekonomik të mësipërm, për mospërmbushje të kriterëve të vecanta kualifikuese.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë BOE “LIGUS” shpk & “AZ TRADING” SHPK” me NUIS L51523001S & L81515016F dhe adresë “*Kashar, Rruga Teodor Keko, Pallati 2Art Kontruksion, Ap. 13*” & “*Nj. Adm Nr.7, Blv. Gjergj Fishta, Kulla G&P, Kati 1*”, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 35,616,225 (tridhjetë e pesëmilionë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e mijë e dyqind e njëzetë e pesë) lekë pa TVSH është identifikuar si fitues (paraprak) i procedurës së prokurimit.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”.

ADMINISTRATOR

Olsi Isufaj